



01/Nr. 7635/2024
Data : 10.08.2024

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e tetë -VIII- për vitin 2024 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 20.08.2024 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2024.
3. Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2025.
4. Propozim vendim për miratimin e planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit në territorin e komunës së Hanit të Elezit për vitet 2024-2029.
5. Raporti për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2023.
6. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023-2024.
7. Informatë për korrje shirjet.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:-për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- propozoj që të hynë në rend të ditës plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve. Materialin do tu a përcjelli për mbledhje të kuvendit të komunës.

Kryesuesi thekson:- propozimin e z.Hisni Luri e hedh në votim , rezultati i votimit ishte një zëri. Në tërësi e hedh rendin e punës në miratim; rezultati i votimit ishte një zëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2024.
3. Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2025.
4. Propozim vendim për miratimin e planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit në territorin e komunës së Hanit të Elezit për vitet 2024-2029.
5. Raporti për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2023.
6. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023-2024.
7. Informatë për korrje shirjet.
8. Plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- në raport janë të përfshira të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e kryetarit të komunës, drejtorive dhe të zyreve përkatëse. Janë arritur disa marrëveshje, me organizatën TOKA dhe Fakultetin e Edukimit, për projektin "Të nxënit përmes përvojës", Marrëveshje me Shoqata e Pensionistëve të TMK - FSK - për trajnimin të stafit teknik të shkollave të Hanit të Elezit rreth përdorimit të pajisjeve kundër zjarrit, Transferuam stafin e pylltarisë, rojet e pyllit dhe digasteret e ngjajshme nga komuna në Agjencinë Pyjore të Kosovës, sipas Marrëveshjes mes Komunës, MAPL dhe MBPZHR, duke përmbushur objektivin e përgjithshëm të kthimit të kompetencave në zbatimin e nenit 76 të pikës 7 të Ligjit nr. 08/L-137 për pyjet, Marrëveshje bashkëpunim me Postën e Kosovës - me qëllim të njoftohen qytetarët dhe të posedojnë në kohë sa më të hershme faturën e tatimit në prone, Memorandum mirëkuptimi me Shoqatën Ahmadiyya Muslim Jamaat Kosova për furnizim me produkte ushqimore për 10 familje për gjashtë muaj me radhë, Lidhëm marrëveshje për heqjen e shpenzimeve të varrimit për të gjitha rastet mortore në qytetin e Hanit të Elezit pa dallim, ku në raport me inflacionin, nga 170 € sa ishte me marrëveshjen e vjetër, u bë 250 €, Marrëveshje për projektin për "Asfaltimi i rrugës 'Ekzodi 99'" së bashku me Ministrin e Ministrisë e Zhvillimit Rajonal, Memorandum bashkëpunimi me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë për krijimin e partneritetit me qëllim të shkëmbimit dhe ofrimit të këshillave profesionale për bizneset në fusha të ndryshme, si dhe asistimin, promovimin dhe përkrahjen e bizneseve anëtare të Dhomës së Tregtisë, Memorandum bashkëpunimi - Projekti për furnizimin me mjete didaktike të dhomës për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta

në komunën e Hani i Elezit, Marrëveshje bashkëpunim me Kolegjin AAB, Marrëveshje me Fondacionit CNVP dhe Organizatës LAB - qëllimi është stimulimi i menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, Pranim dorëzimit të gjeneratorit për fabrikën e ujit në fshatin Dimcë nga organizata LDS e drejtuar nga z.Clay dhe znj. Catherine Stringham, Marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës, - qëllimi është realizimi i projektit të rrugës Krivenik – Gorancë, Marrëveshje bashkëpunim me Kompaninë Sharrcem për pranim-dorëzimit të një autoambulance me të gjitha pajisjet e nevojshme, Marrëveshje me Shërbimit Sprovues të Kosovës - për lehtësimin e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative, pjesë e trajtimit nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, Marrëveshje me "Poliklinika Pleura" - 30% zbritje për çdo shërbim që ofron për banorët e Hanit të Elezit me kushte të vështira ekonomike, familjarët e tyre dhe veteranët e luftës dhe familjet e tyre. Janë hartuar disa projekte të reja . Ndërtimi i ballkonit panoramik te shkronjat e UÇK-së , Ndërtimi i Parkut “Te pishat” në fshatin Gorancë, Projekti i resaturimit të Bunkerave tek parku “Isa Berisha”, Projekti i asfaltimit tek Parku Memorial “Bllaca 99”, Projekti i asfaltimit të rrugës “Nehat Curri”, Projekti i Rregullimi i deponisë së mbeturinave të ngurta në fshatin Gorancë. Janë subvencionuar organizata dhe klube të ndryshme , bizneset për herë të parë . iniciativa që janë marr gjatë këtij gjashtë mujori është transmetimi lajv i seancave të Kuvendit të Komunës përmes televizionit, mbështetje të rinjveve përmes punës praktike në bashkëpunim me entin e punësimit.

Hyriete Isufi thekson:- te vlera e parashikuar te servisimi i veturave a janë bërë kontratat apo është vetëm parashikimi apo mbetet deri në fund të vitit. Kërkoj sqarim për kodini ekonomikë pasuri jo financiare. Në raport shënon se janë shuar pesë biznese kërkoj sqarim se për cilat biznese bëhet fjalë.

Natya Kalisi thekson:- janë pesë procedura në lidhje me servisimin dhe mirëmbajtje të automjeteve dhe kemi bërë procedurë të ndarë për lloje dhe kjo është vlera e planifikuar, ndërsa sa i përket shpenzimit varet se sa dëmtohen automjetet

Kryesuesi thekson:- dritaren e veturës Toyota kam kërkuar që me ndërruar afër një vit .

Natya Kalisi thekson:- informatën e kam pasur me vonesë në lidhje me dëmtimin e asaj dritare dhe nuk ka qenë e përfshirë në kontratë dhe në momentin që do të kemi ndonjë zgjidhje do të rifunkcionizohet .

Kryesuesi thekson:- e kam njoftuar personin kompetentë që merret me çështje të veturave z.Sadik Brava dhe nuk e kuptoj pse është hequr prej kontratës ndërrimi i dritares.

Natya Kalisi thekson:- nëse i keni treguar z.Sadik Brava por ai nuk më ka informuar me kohë .

Kryesuesi thekson:-tash jeni e informuar dhe e rregulloni këtë çështje.

Lindita Ballazhi thekson:- është ndërruar plani kontabël dhe emërtimi i projekteve kapitale emërtohet si pasuri jofinanciare

Majlinda Kaloshi thekson:- janë shuar pesë biznese individuale dhe janë ato lloje të bizneseve të cilët kanë kërkuar në mënyrë vullnetare që me ndaluar ushtrimin e veprimtarisë ekonomike.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR PEIUDHË JANAR-QERSHOR 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- para jush e keni shkresën për plotësimin ndryshimin e rregullores për taksa për vitin 2025. Në material janë të shënuara propozimet për plotësim ndryshim.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RREGULLORJA PËR TAKSA KOMUNALE PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Propozim vendim për miratimin e planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit në territorin e komunës së Hanit të Elezit për vitet 2024-2029.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- në mbledhjen e muajit prill të këtij viti kemi miratuar vendimin për hapjen e debatit publik për planin lokal për cilësi të ajrit. Është kryer debati publik dhe është njoftuar Ministria dhe tani dokumenti është gati për miratim .

Sherif Berisha thekson:- edhe më herët kam kërkuar që të caktohet një person përgjegjës prej komunës për matjen e cilësisë së ajrit.

Nexhmedin Daci thekson:- janë të planifikuara për vitin 2026-2027 por nuk janë pajisje të lira të cilat varen prej vendimeve të cilat do të merren në kuvend dhe prej mundësive buxhetore.

Hyriete Isufi thekson:- faqe tridhjetë e dy janë dy paragrafe komplet të njëjta dhe është mirë të përmirësohen për mbledhje të kuvendit.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR CILËSI TË AJRIT NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITET 2024-2029 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Raporti për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- materialin e keni në mënyrë të detajuar dhe nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mundeni me parashtruar.

Sherif Berisha thekson:- pse komuna jonë nuk është përfituese e asnjë grandit.

Natyra Kalisi thekson:- gjatë vitit 2022 kemi pasur problem për shkak se buxheti ka qenë i shpenzuar por për shkak të donacionit nga Qeveria Japoneze në muajin dhjetorë që është e pa mundur me zhvilluar procedura të prokurimit, po ashtu edhe për vitin 2023 kemi pasur donacion prej Bashkimit Evropianë në muajin dhjetorë mirëpo edhe auditori e ka dhanë sqarimin për çështjen e donacionit për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË KOMUNËS PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023-2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:- në të gjitha shkollat ka vërejtje të nxënësve dhe nëse një nxënë i ka 30 vërejtje çka ndërmerret.

Hisni Luri thekson:- në bazë të udhëzimit administrativ çdo nxënës merr vërejtje nga arsimtarët, arsyetohen te kujdestarët dhe kujdestari në bashkëpunim me prindin marrin masa dhe nëse nuk merren masa për vërejtjen e caktuar mund të shqyrtohet te arsimtari tjetër, kalon në instanca pak më të larta te këshilli i mësimdhënësve, aty vendosin në bashkëpunim edhe me prindërit edhe me drejtorinë e shkollës, nëse edhe këtu nuk merren masa kalon te drejtoria e shkollës e cila i ka për obligim që ty shqyrton vërejtjet për shkak se është më kompetentë që të merret me nxënësit dhe me mësimdhënësit. Si drejtori asnjëra prej vërejtjeve nuk na ka ardhur në drejtori të arsimit sepse duhet të dërgohen në komision disiplinorë dhe pastaj e shqyrtojmë në bazë të komisionit disiplinorë. Mund të jetë neglizhencë e drejtorit që nuk ka marr masa të tilla .

Kryesuesi thekson:- a ka kontrolla nëpër shkolla.

Hisni Luri thekson:- është vetëm një inspektorë regional për me ardhur dhe me bërë hospitim në shkolla por në momentin që ka gjetur disa vërejtje dhe ka dhënë rekomandime të cilat janë kryesisht për stafin e shkollës dhe drejtorinë e shkollës. Ne do të marrim masa që të përmirësohen dhe disa prej tyre i kemi përmirësuar por kanë mbetur edhe disa tjera për me i përmirësuar.

Nora Xhoni thekson:- në informatë shënon që prej klasës së parë deri në të nëntën katërdhjetë nxënës më pakë. A keni numër të saktë të largimit në nxënësve.

Hisni Luri thekson:- ka të bëjë me ata të cilët nuk janë të regjistruar. Numri i largimit të nxënësve është pesëdhjetë e dy.

Xhevahir Dernjani thekson:- sa është numri i nxënësve të cilët kanë probleme me shikim, me dëgjim, me të folur.

Hisni Luri thekson:- janë njëzet e dy nxënës me nevoja të veçanta.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI SUKSESIN E ARRITUR TË NXËNËSVE NË SHFMU DHE SHML NË FUND TË GJYSMËVJETORIT NË FUND TË GJYSMËVJETORIT TË DYTË TË VITIT SHKOLLOR 2023-2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Informatë për korrje shirjet.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- procesi i korrje shirjeve është zhvilluar normalisht në bazë të kushteve që i kemi dhe dy vitet e fundit kemi rritje të sipërfaqeve të grurit. Përveç materialit të cilit ua kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATË PËR KORRJE SHIRJET QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- plotësim ndryshimi do të bëhet te neni 14 paragrafi dy subvencionet për arsim dhe të ndryshohet vendimi i Kuvendit të Komunës ku do të rritet numri i bursistëve nga katërdhjetë në pesëdhjetë bursistë si dhe harmonizimi i rregullores me rregulloren e Ministrisë të komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLOTËSIM NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURAT E NNDARJES SË SUBVENCIONEVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- pjesa e te fabrika e Stiroporit ka fjet , po ashtu edhe te Jona market është mirë me intervenuar . Te shtëpia e z.Nexhmedin Fida edhe aty ka fjet ajo pjesë . Shportat e mbeturinave të cilat janë vendosur në Lagje të Re a janë vendos nga komuna apo nga dikush privat.

Arhim Dernjani thekson:- shportat në Lagje të Re nuk kam ndonjë informacion se kush i ka vendosur. Çështjen e gropave që e potencove jemi në procedurë dhe por presim që zotimin e mjeteve me najë lëshuar Qeveria.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:15.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi

